

Kolegji Bramson ORT është i vendosur që të sigurojë një klimë të shëndoshë pune dhe arsimimi që do të çojë në zhvillimin vetjak dhe profesional të çdo studenti. Kolegji Bramson ORT është i vendosur të mbajë një atmosferë që është e lirë nga diskriminimi dhe që përputhet me Titullin VI e të Drejtës së Qytetarit Akti I 1964, e Drejta IX e Amendamentit të Edukimit të vitit 1972, artikulli 504 i Aktit të Reabilitimit të vitit 1973 dhe të Aktit për Amerikanët me Paaftësi të vitit 1990.

## TË DREJTAT CIVILE (Qytetare)

Kolegji Bramson ORT nuk diskriminon në bazë të apo perceptimit të racës, etnisë, ngjyrës, vendit të origjinës, fesë, gjinisë, paaftësisë (mendore, fizike apo emocionale), moshës, qënies si veteran, drejtimit seksual, gjëndjes martesore dhe kushteve mjekësore në programet dhe aktivitetet e veta arsimore dhe të punësimit. Kolegji Bramson ORT nuk diskriminon në pranimin e studentëve, punonjësve apo atyre që aplikojnë rregullat arsimore, bursat dhe planifikimin e huave, si dhe për programe të tjera të lidhura me pranimin në kolegji.

Shqetësimi i studenteve për shkak të racës, ngjyrës, dhe/ose origjinës kombëtare është shkelje e Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964. Një mjedis i pafavorshëm racial mund të krijohet nga fjalët, nga të shkruarit, nga vizatime ose sjellje trupore që lidhet me racën, ngjyrën, ose kombësinë e një individi që është mjaftueshmërisht e rëndë, e vazhdueshme ose që shtrihet aq sa të ndërhyjë me ose të kufizojë aftësinë e studentit të marrë pjesë ose të përfitojë nga programet ose veprimtaritë e Kolegjit.

## DISKRIMINIMI SEKSUAL/NGACMIMI SEKSUAL

Ngacmimi seksual, një formë e diskriminimit të bazuar në gjini, është një shkelje e titullit IX e Aktit Rregullues për Arsimin të vitit 1972. Ngacmimi Seksual mund të marrë forma të ndryshme dhe është përgjithësisht i përcaktuar si një sjellje e pakërkuar, fyese përkundër një tjetri. Mund të jetë, por jo vetëm, si më poshtë: ngacmim gojor, i shkruar, ose i dërguar nëpërmjet kompjuterit që përfshin vërejtje ngacmuese, nënkuptime, fyerje, humor apo shaka; propozime; kërcënime; ngacmimi jo-gojor përbëhet nga shenja të pahijshme, shikim vëngër ose të përpit me sy; ngacmimi fizik përbëhet nga prekja, përkëdhelja, pickimi, fërkimi trupor; marrëdhënie seksuale me detyrim; përdhunim.

Kolegji Bramson ORT përputhet me Titullin IX të Aktit Rregullues për Arsimin të vitit 1972 i cili mbron individët nga diferencimi, diskriminimi në bazë të seksit në veprimtarinë e programeve të saj arsimore dhe procedurat e veta të punësimit. Kolegji Bramson ORT mundohet të krijojë e të mbajë një mjedis pa frikësime dhe ngacmime seksuale. Kjo është shkelje e rregullave të Kolegjit për të gjithë anëtarët e kolektivit që angazhohen në ngacmim seksual ose për ata që kryejnë veprime kundra një individi që ka raportuar ngacmimin. Sipas udhëzimeve të Komisionit të Mundësive të Barabartatë Punësimit (KMBP), "propozime të pamirëpritura seksuale, kërkesa për favore seksuale dhe sjellje të tjera gojore apo fizike të një natyre seksuale përbëjnë ngacmim seksual kur:

- Nënshtrimi ndaj një sjelljeje të tillë bëhet në mënyrë direkte apo indirekte për një afat apo një kushtëzim që lidhet me punësimin e një individi ose me atë se ku qëndron ai me nivelin e tij akademik;
- Nënshtrimin ndaj mospranimit të një sjelljeje të tillë nga një individ është përdorur si bazë për punësim ose për vendime të natyrës akademike që e prekin një individ të tillë; ose
- Një sjellje e tillë ka për qëllim ose shkakton një ndërhyrje të paarsyeshme që pengon kryerjen e detyrës nga një individ ose që krijon një mjedis pune që frikëson, është armiqësor, ose fyes. “

Individët që kërkojnë informacion rreth Titullit IX të Aktit Rregullues për Arsimin të vitit 1972 ose personat të cilët besojnë se janë të diskriminuar vetëm mbi bazën e gjinisë së tyre mund të lidhen me Nënpunësin e të Drejtave Qytetare: Aisha Cesar tel. 718-261-5800, shtesa 1075 ose [acesar@bramsonort.edu](mailto:acesar@bramsonort.edu).

## TË DREJTAT E PERSONAVE ME PAAFTËSI

Në përputhje me seksionin 504 të Aktit të Reabilitimit të 1973 dhe Aktin e Amerikanëve me Paaftësi (AAP), Kolegji Bramson ORT ndalon çdo formë diskriminimi kundër individëve që klasifikohen si të tillë në bazë të dëmtimeve fizike apo mendore për të gjitha qëllimet arsimore apo të punësimit, duke përfshirë vlerësimet dhe vendosjet në pranim, programet, aktivitetet dhe kurset, këshillimin, ndihmën financiare, huatë dhe bursat, dhe punësimin. Kolegji nuk diskriminon studentët që konsiderohen me paaftësi në çdo njërin nga programet akademike, aktivitetet apo shërbimet e tij.

Brenda mundësive të gjykuara dhe pa shkaktuar vështirësi të panevojshme financiare për kolegjin, zyra e Dekanit për Shërbimin Akademik do të ndihmojë studentët me paaftësi që të kenë aparate dhe mjete ndihmëse nga njësitë shtetërore, që përfshijnë referime tek agjensitë shtetërore të reabilitimit profesional ose tek organizata bamirëse. Studentët me paaftësi priten të përdorin ndihmën vetjake që të marrin dhe mirëmbajnë fondet marrë nga burime të tjera për aparatet dhe mjetet ndihmëse. Nëse Kolegji nuk mund të sigurojë materialet dhe aparatat ndihmëse në fillim të çdo simestri, studentët të cilët besojnë që ata do të kenë nevojë për këto voli janë të këshilluar të njoftojnë Zyrën e Dekanit të Shërbimit Akademik të paktën pesë (5) javë përpara ditës së parë të klasave për atë periudhë. Një njoftim i tillë është i nevojshëm në mënyrë që t'u japë kohë studentëve dhe Kolegjit Bramson ORT për një periudhë në të cilën:

- Të vlerësojë nëse ndihma e kërkuar është e nevojshme dhe do t'i sigurojë studentit një mundësi të barabartë me të tjerët që të përfitojë nga programet arsimore të kolegjit pa e rënduar kolegjin me vështirësi ekonomike të panevojshme.
- Të përcaktojë burimet për blerjen, huazimin, ose përdorimin e paisjeve që ndihmojnë në mësim.
- Të sigurojë fondet, nëse është e mundur, për pajisjet dhe mjetet ndihmëse nga agjensitë e përshtatshme shtetërore apo bamirëse.

Nëpunësi i Mbarëvajtjes së të Drejtave Qytetare bashkërendon zbatimin erregullave që përmbahen në Seksionin 504 dhe në Aktin e Amerikanëve me Pamundësi. Çdo student apo punonjës që beson se i janë mohuar të drejtat dhe përfitimet nën seksionin 504 të Aktit të Reabilitimit të 1973 apo Aktin e Amerikanëve me Paaftësi mund të ankohet me shkrim. Proçesi i brendshëm për aplikimin dhe zgjidhjen e ankesave për diskriminim mund të gjënden në pjesën me titull “ Kolegji Bramson ORT Rregullorja e Ankesave për Studentët” në Manualin e Studentëve.

Shqetësimi për paaftësi, një formë e diskriminimit e bazuar në një paaftësi, është një shkelje e Paragrafit 504 të Aktit të Reabilitimit të vitit 1973 dhe të Aktit të Amerikanëve me Paaftësi të vitit 1990. Shqetësimi për paaftësi mund të marrë forma të ndryshme. Zakonisht është i përcaktuar si “ një sjellje frikësuese apo fyese kundrejt një studenti e bazuar në një paaftësi,” dhe përfshin veprime verbale ose vënie emrash, si dhe veprime pa fjalë, sic janë vizatime ose pohime të shkruara, ose sje lje që përbëjnë kërcënim fizik, dëmtim, ose poshtërojnë.

## KOLEGJI BRAMSON ORT RREGULLAT E ANKESAVE PËR STUDENTET

Më poshtë janë procedurat formale dhe jo-formale që kanë për qëllim të zgjidhin një ankesë ardhur nga një pohim i shkeljes së të drejtave qytetare në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë. Ndërsa në shumë raste bërja e një ankese jo-formale është e shpejtë, përdorimi i procedurave jo-formale nuk është kusht paraprak për fillimin e një procedure formale. Kolegji sugjeron që ankuesi të mbajë kopje të të gjithë letërkëmbimit që është i lidhur me çështjen. Cdo ankesë formale apo jo-formale duhet ti referohet Nënpunësit të Mbarëvajtjes së të Drejtave Qytetare:

Aicha Cesar

Nënpunësi i Mbarëvajtjes për të Drejtat Qytetare

Telefoni: 718-261-5800, zgjatja 1075

Email: [acesar@bramsonort.edu](mailto:acesar@bramsonort.edu)

TDD: 718-704-1407

Asnjë veprim nuk do të ndërmerret kundër studentëve që regjistrojnë një ankesë.

Rregullat e veprimit për zgjidhjen e ankesave formale dhe jo-formale i takojnë vetëm çështjeve të lidhura me të drejtat qytetare, shqetësimin seksual dhe paaftësinë dhe nuk kanë të bëjnë me çështje akademike ose me ato të natyrës që lidhen me vendin e punës.

### ANKESAT JO-FORMALE

Ne e nxisim ankuesin që të flasë me një person që ai ose ajo beson është përgjegjës për shkeljen e rregullave të Bramson ORT. Nëse nuk është e mundur, ankuesi mund ti drejtohet Dekanit të Shërbimeve Akademike dhe/ose Nënpunësit të Mbarëvajtjes së të Drejtave Qytetare (NMDQ). Nëse ankuesi beson që ai ose ajo kanë vuajtur nga shqetësimi seksual ose një sulm i tillë, ai ose ajo nuk duhet t'i drejtohet personit të akuzuar. Ankuesi nxitet të plotësojë Formën e Ankesës të Bramson ORT dhe të përshkruajë shkeljen e supozuar me sa më shumë hollësi që të jetë e mundur, duke përfshirë datën e ankesës(ve), personin, si dhe sektorin ku përfshihet në të gjitha dokumentat e dhura. Dekani i Shërbimeve Akademike dhe/ose Nënpunësi i Mbarëvajtjes i të Drejtave Qytetare duhet të përpiqen që ta zgjidhin ankesën brenda 10 (dhjetë) ditë pune. Fshehtësia a ankuesit do të mbahet aq sa përcaktohet nga ligji. Nëse ankesa është zgjidhur, nuk do të ndërmerret asnjë veprim.

Nëse ankesa nuk është zgjidhur në mënyrë të kënaqëshme siç përcaktohet nga ankuesi, ai ose ajo duhet të marrë në konsideratë që të shkruajë një ankesë formale dhe të hapë një dosje për të. Gjithashtu, ankuesi mund të ndryshojë mëndjen dhe të shkruajë e të aplikojë për një ankesë formale në çdo kohë.

## ANKESAT FORMALE

### **Hapi 1:**

Një ankesë formale e shkruar do t'u dorëzohet Nënpunësit të Mbarëvajtjes e të Drejtave Qytetare brenda afateve si më poshtë:

- Brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune që nga koha e ndodhisë ose që nga koha që për herë të parë ankuesi u bë i ndërgjegjshëm për shkeljet e mundëshme të të drejtave qytetare OSE;
- Brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune pasi të kenë aplikuar për një ankesë jo-formale OSE;
- Brenda 20 (njëzet) ditësh pune pas njoftimit të marrë për ankesën jo-formale.

Për të gjitha ankesat formale dhe jo-formale , afatet kohore mund të shtyhen varur nga arsye të qënësishme.

Personave me paaftësi duhet ti jepen mjetet ndihmëse dhe shërbime në mënyrë që ti ndihmojnë që të shkruajnë dhe të depozitojnë një ankesë dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e ankimit.

NMDQ do të planifikojë një takim brenda pesë (5) ditësh pune. Ankuesit do t'i bëhen të ditura të drejtat dhe mundësitë në përpjekjen për të zgjidhur ankesën. Ankuesi duhet të plotësojë Formën e Ankesës së Kolegjit Bramson ORT dhe të përshkruajë shkeljen e supozuar me sa më shumë hollësi që të jetë e mundur, duke përfshirë datën e ngjarjes (ve) për të cilën është bërë ankesa, personin (at) dhe sektorin që është përfshirë. Asnjë veprim i mëtejshëm nuk do të ndërmerret nëse ankesa nuk është bërë me shkrim. Disa ankesa gjithashtu mund t'u takojnë autoriteteve të tjera, si agjensi apo organizata që s'kanë të bëjnë me kolegjin Bramson ORT. Këto ankesa duhet t'i dretohen subjekteve që kanë autoritetin e nevojshëm.

### **Hapi 2:**

Brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pune nga dita e depositimit të ankesës formale me Nënpunësin e Mbarëvajtjes së të Drejtave Qytetare, Drejtori i Burimeve Njerëzore do ti tregojnë ankuesit për gjëndjen e hetimit, gjetjet dhe rekomandimet e Nënpunësit të Mbarëvajtjes së të Drejtave Qytetare. Drejtori i Burimeve Njerëzore do të shqyrtojë dhe do të marrë një vendim me shkrim për sa i përket ankesës. Vendimi i shkruar, që do të përshkruajë masat e marra për korrigjimin e shkeljes do të lëshohet nga Drejtori i Burimeve Njerëzore brenda 45 ditësh pune prej ditës së paraqitjes së ankesës formale.

### **Hapi 3:**

Ankuesi mund të apelojë vendimin e marrë nga Presidenti i Kolegjit. Apeli duhet të bëhet me shkrim dhe brenda afatit prej 10 ditësh pune nga dita e njoftimit për vendimin e

marrë nga Drejtori i Burimeve Njerëzore. Presidenti i Kolegjit do të marrë vendimin përfundimtar brenda 10 ditë pune që nga dita e dorëzimit të letrës për apelim. Vendimi i Presidentit të Kolegjit është hapi i fundit në procesin e ankesave të Kolegjit Bramson ORT.

#### **Hapi 4:**

Çdo person në çdo kohë mund të aplikojë për një ankesë me shkrim:

Zyra e të Drejtave Qytetare (ZDQ)  
S.B. Seksioni i Edukimit  
32 Old Slip, Kati i 26  
New York, NY 10005-2500  
Tel: 646-428-3900  
Fax: 646-428-3843; TDD: 800-877-8339  
Email: [OCR.NewYork@ed.gov](mailto:OCR.NewYork@ed.gov)  
<http://www2.ed.gov/about/offices/list/ocr/docs/howto.pdf>

Për të gjitha ankesat formale dhe jo-formale, afatet kohore mund të caktohen me marrëveshje prej të dy palëve. Të gjitha ankesat janë të fshehta dhe asnjë veprim rregullues nuk do të ndërmerret kundrejt akuzuesit për depozitimin e ankesës. Materialet e të gjitha ankesave formale do të mbahen të arkivuara për të paktën 3 (tre) vjet pas zgjidhjes.

*Kolegji Bramson ORT rezervon të drejtën të bëjë ndryshime në këtë Manual. Rregullat, procedurat, linjat e veprimit, dhe çdo informacion tjetër që përmbahen në, të gjitha mund të ndryshohen. Përmbajtja e këtij libri është subjekt ndryshimi pa paralajmërim dhe duhet të përdoret vetëm për qëllim informacioni.*